



INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE, NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUT

Në bazë të nenit 20 paragrafi 14, i Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, dt. 15.08.2017, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datë 23.09.2019, miratoj këtë:

RREGULLORE për punën e Këshillit Drejtues të Institutit Pedagogjik të Kosovës

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e funksionimit të Këshillit Drejtues (këtu e tutje, Këshilli), organizimi dhe mbajtja e mbledhjeve, mënyra e votimit si dhe punë tjera të përcaktuara me dispozita ligjore.

Neni 2 Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit

- 1.Këshilli është organ kolegjal qeverisës i Institutit Pedagogjik të Kosovës (këtu e tutje, IPK)
- 2.Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtar
- 3.Drejtori i IPK-së është anëtar i Këshillit, sipas detyrës zyrtare
- 4.Dy anëtar të Këshillit emërohen nga MASHT
- 5.Dy anëtar të Këshillit zgjedhen nga personeli i IPK-së me anë të votimit të fshehtë
- 6.Të gjithë anëtarët e stafit të IPK-së kanë të drejtë të zgjidhen për anëtar të Këshillit
- 7.Votimi për anëtar të Këshillit mund të bëhet vetëm atëhere kur janë prezent në mbledhje së paku dy të tretat (2/3) e personelit të IPK-së
- 8.Për të hyrë në garë për anëtar të Këshillit duhet të propozohen 5 (pesë) anëtar nga personeli i IPK-së, të cilët i nënshtrohen votimit të fshehtë
- 9.Dy anëtar nga personeli i IPK-së të cilët marrin më së shumti vota bëhen anëtar të Këshillit
- 10.Mandati i anëtarve të Këshillit zgjatë katër (4) vjet
- 11.Anëtarët e Këshillit mund të rizgjedhen vetëm edhe për një mandat

12. Anëtarët e Këshillit ushtrojnë detyrën e tyre bazuar në respektimin e plotë të lirisë dhe pavarësisë profesionale në marrjen e vendimeve
13. Në mbledhjen e parë verifikohet lista e anëtarve të Këshillit
14. Nëse Këshilli dyshon se ndonjë anëtar është zgjedhur apo emëruar në mënyrë jo të rregullt ose ekziston ndonjë konflikt interesi, kërkohet nga MASHT/IPK që të dërgohen propozime tjera brenda dy javësh
15. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit i zgjedhur nga IPK tërhiqet për cilëndo arsye apo largohet nga IPK, atëherë duhet që brenda dy javësh IPK të propozon-zgjedhë anëtar të rinj të zgjedhur sipas të njëjtave procedura të votimeve në përshtatshmëri me pikat 5-9 të këtij neni

Neni 3

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit

1. Këshilli miraton Statutin, pas marrjes së pëlqimit nga MASHT, dhe miraton aktet tjera juridike të Institutit
2. Miraton rregulloren e brendshme të punës së IPK-së
3. Miraton planin vjetor të punës dhe planin financiar të IPK-së
4. Shqyrton dhe aprovon raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të IPK-së
5. Ndërmerr masa për organizimin dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në IPK
6. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e IPK, në bazë të procedurave të përcaktuara me Statut, sipas nenit 22 (hap konkursin për drejtor në bazë të ligjit dhe statutit)
7. Këshilli, drejtori dhe Këshilli Shkencor bashkëpunojnë dhe i koordinojnë punët për zhvillimin e projekteve profesionale, hulumtuese të Institutit dhe aftësimin profesional të stafit
8. Këshilli për punën e vet përgatit raport me shkrim për ministrin
9. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e punëtorëve që lidhen me marrëdhënien e punës në IPK
10. Vendos edhe për çështje të tjera në bazë të UA dhe Statutit
11. Vendimet për çështje të rëndësishme për IPK-në, Këshilli vendimet i merr me shumicë absolute të votave
12. Kur vendoset për çështje që ndërlidhen me drejtorin, drejtori nuk merr pjesë në votim

Neni 4

Mbledhjet e Këshillit

1. Mbledhjet e Këshillit i thërret dhe kryeson drejtori i IPK-së
2. Në mungesë të drejtorit, mbledhjen e udhëheq anëtari më i vjetër në Këshill
3. Drejtori i thërret mbledhjet edhe në bazë të kërkesës së 1/3 të anëtarve të Këshillit dhe sipas nevojës që kërkohet
4. Rëndin e ditës në mbledhje e paraqet drejtori dhe mund të plotësohet nga anëtarët tjerë para se të miratohet
5. Mbledhje të jashtëzakonshme mund të thirren në çfarëdo kohe, sipas procedurave të parapara me ligj

- 6.Ftesa për mbledhje dërgohet me shkrim, e-mail apo në çfarëdo forme tjetër, së paku 48 orë para mbledhjes
- 7.Në mbledhje të Këshillit, anëtarët duhet të votojnë personalisht
- 8.Votimi në Këshill kur ka të bëjë me zgjedhjen apo emërimin e nje personi bëhet me votim të fshehtë, si dhe kur Këshilli e sheh të arsyeshme se duhet votim i fshehtë.
- 9.Në fillim të mbledhjes anëtarët e pranishëm në mbledhje nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit.
- 10.Anëtari i Këshillit mund të mungoj në mbledhje vetëm për shkaqe të arsyeshme
- 11.Për mungesën në mbledhje, anëtari i Këshillit duhet paraprakisht ta njoftoj kryesuesin
- 12.Anëtari i Këshillit i cili mungon në tri mbledhje radhazi pa paralajmërim te kryesuesi i KD-së, e humb mandatin si anëtar i KD
- 13.Me ftesë të KD në takime mund të marrin pjesë edhe anëtarë tjerë të IPK-së por pa të drejtë vote
- 14.Në rastet kur KD dhe drejtori nuk mund të pajtohen për ndonjë çështje të rëndësishme, e cila nuk kalon me votë, kryesuesi i KD e ndërpret mbledhjen dhe për atë çështje kërkon qëndrim zyrtar nga ministri

Neni 5

Mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve të KD-së

1. Në çdo mbledhje të KD mbahet procesverbali
2. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi
3. Procesverbali duhet të përmbaj këto elemente:
 - 3.1 Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes
 - 3.2 Rendin e ditës
 - 3.3 Listën e pjesëmarrjes
 - 3.4 Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse
 - 3.5 Shënimet thelbësore mbi rrjedhen e mbledhjes
 - 3.6 Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit si aneks
4. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së KD dhe si ekstrakt duhet t'iu dërgohen anëtarve të KD me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të KD
5. Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të KD
6. Procesverbali ruhet në arkiv të IPK-së me materialet tjera sipas pikave të rendit të ditës si dokument afatgjatë

Neni 6

Mbikëqyrja dhe zbatimi i rregullorës

1. Dispozitat e kësaj rregullore vlejnjë për të gjithë anëtarët e KD dhe personat tjerë të ftuar ose angazhuar në procedurat, funksionimin dhe punën e KD
2. Për zbatimin e drejtë të kësaj rregullore kujdeset kryesuesi i KD

Neni 7

Interpretimi i Rregullorës

1. Interpretimin e kësaj rregullore e bënë zyrtari ligjor i IPK-së.

Neni 8

Çdo ndryshim dhe plotësim i kësaj rregullore duhet të bëhet sipas procedurave të njëjta të nxjerrjes dhe miratimit.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në KD dhe nënshkrimit nga kryesuesi i KD

Kryesues i KD

Nezir Çoçaj

